

D E K R E T
Nr.1047, datë 22.3.1995

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7527, DATË 11.12.1991 “PËR SHËRBIMIN
USHTARAK NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes,

D E K R E T O J:

Neni 1

Në ligjin nr.7527, datë 11.12.1991 “Për shërbimin ushtarak në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, neni 15 gërma “a” ndryshohet si vijon:
"Për shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv 12 muaj".

Neni 2

Ministria e Mbrojtjes të marrë masa për zbatimin e këtij dekreti duke bërë planifikimet e nevojshme.

Neni 3

Efektet e këtij dekreti nuk përfshihen për shtetasit që deri në hyrjen në fuqi të tij janë duke kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv.

Neni 4

Ky dekret hyn në fuqi më 1 prill 1995.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha

KUNDËRFIRMOHET
MINISTRI I MBROJTJES
Safet Zhulali

KRYEMINISTRI
Aleksandër Meksi

Miratuar me ligjin nr.7924, datë 19.4.1995 të Kuvendit Popullor.